

PREMIX**PËRSHKRIMI**

Suva mbushëse me bazë çimento-gëlqere për mure të brendshme, tavane dhe fasada. I përshtatshëm për të gjitha tipet e bazamenteve si: mur tulle, mure me blloqe betoni, gur ranorë dhe gëlqerorë. Nuk është i përshtatshëm për bazamente me lagështi të vazhdueshme. I krahasuar me llaçin tradicional redukton 25% të sasisë në aplikim.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret mbi të gjitha tipet e bazamenteve, tulla të kuqe, tulla me vrimë, tulla me porozitet të lartë, gurë, etj. Shtresë dorë e parë për mbushjen e tavaneve, mureve të brendshme dhe të jashtme, larje dorë e dytë për të eliminuar plasaritjet. Për tulla silikate me porozitet të lartë përpara aplikimit të llaçit kalohet astar akrilik i holluar 1 me 2 me ujë për të eliminuar pluhurat. Në sipërfaqet me beton rekomandohet aplikimi i beton primer i holluar 10-20%.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike. Në rastin kur kemi të bëjmë me kanale të instalimeve elektrike, ato duhet të mbyllën paraprakisht përpara fillimit të suvatimit. Në pjesët e trarëve, kolonave apo sipërfaqe betoni duhet kaluar patjetër Beton Contact / Beton Primer, në mënyrë që llaçi të ngjisë sa më mirë dhe të eliminohen plasaritjet.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Produkti është i përshtatshëm për t'u punuar me dorë dhe makineri. Përzieni me një përzierës mekanik ose me makineri 5.5-6 litra ujë me një thes 25 kg PREMIX derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza.

APLIKIMI ME DORË

Aplikoni me mallën e duhur produktin e përgatitur dhe bëni nivelimin me mastar. Pas tharjes është e nevojshme që përpara vendosjes së finos të bëhet ashpërsimi i sipërfaqes së suvasë. Temperaturat optimale të punimit janë nga +5°C deri në +35°C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje.

APLIKIMI ME MAKINERI

Bëhet në tre mënyra:

1. Me fasho dhe dy duar suvatim.
2. Me fasho, një dorë mbushje dhe një dorë larje për eliminimin e plasaritjeve të mundshme.
3. Me fasho, një dorë mbushje dhe ditën tjetër bëhet grryerje e sipërfaqes për ta ashpërsuar produktin, në mënyrë që rifinitura finale të bëjë ngjitje më të mirë.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Gri
Kokrrizimi:	1.2 mm
Konsumi:	1.2m ² /thes/1.5 cm trashësi
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Trashësia min e aplikimit për mure:	Deri në 10mm
Trashësia min e aplikimit për tavane:	Deri në 7-8mm
Konduktiviteti termik:	0.61 W/mK
Koha e punueshmërisë së produktit:	2 orë
Densiteti i llaçit të thatë:	1.5-1.6 gr/cm ³
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Sasia e ujit:	5.5-6 litër ujë / 25 kg produkt
Aplikimi i materialit:	Me dorë ose makineri, 1-2 duar
Koha e pritjes për dorën e dytë:	24 orë
Forca e shtypjes pas 28 ditësh:	≥ 3.5 N/mm ²
Rezistenca në ngjeshje:	≥0.5 N /mm ²
Absorbimi i ujit:	WO
Reaksioni ndaj zjarrit:	Class A1